



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.975/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik OE "ASTRAPLAN" Sh.p.k.- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Olti Trasing" Sh.p.k. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3745-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Ministria e Arsimit, më datën: 02.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "ASTRAPLAN" Sh.p.k.- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3745-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit.
- II. ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3745-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit , dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.
- III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.
- V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "ASTRAPLAN" Sh.p.k.- Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "ASTRAPLAN" Sh.p.k.- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 19.11.2020 me nr. 975/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Çerdhes në Mitrovicë" me nr. të prokurimit: 208 Udhëheqësi-20-3745-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Arsimit, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 10, 56, 59, 60 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, nenin 9.1 & 9.2 të dosjes së tenderit dhe nenin 49.19 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 24.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e dosjes se tenderit dhe shqyrtimit të procesit të vlerësimit të tenderit, konstatojmë me sa vijon:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 10, 56, 59 dhe 108 A të LPP-së dhe nenit 49.19 te RrUOPP, si dhe nenit 9.1 dhe 9.2 të DT, me arsyetimin se:

"Eliminimi i saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhen me dëshmitë e inxhinierit te ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik është në kundërshtim me dispozitat e lartë cekura,"

Duke u bazuar në faktet e gjetura me rastin e trajtimit te lendet eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese është i bazuar sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes se tenderit ka parashtruar kërkesën si vijon:

Kërkesa:

3. Një inxhinier i dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia1-6 Për menaxherin e Projektit Personelin Kryesor Teknik të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuara , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Për udhëheqësin e punimeve dhe personelin teknik diplomat duhet të jetë te noterizuara. (Diplomat jashtë shtetit duhet të jen të nostifikuara)

Ndërsa, OE ankuese së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën e personelit udhëheqës, në të cilën liste ka paraqitur të dhënat e z. Arben Hajrizi në cilësinë e inxhinierit te dip. te ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik, po ashtu për të njëtin ka dorëzuar dëshmitë, kopjen e diplomës së inxhinierit të ndërtimtarisë të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës të vërtetuar tek noteri, kopjen e kontratës së punës për kohë të caktuar, CV dhe referencat e lëshuara nga USAID dhe IRD të cilat dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Eksperti Shqyrtues sqaron se i njëjti inxhinier respektivisht z. Arben Hajrizi është paraqitur si staf me kontratë pune me kohë të caktuar te operatori ekonomik “AC ing” Sh.p.k e cila është pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit si anëtar i konzorciumit tek grapi i OE “AC ing Shpk & Vellezrit Hoti Sh.p.k”, mirëpo eksperti shqyrtues konstaton se askund në legjislacionin për prokurim publik nuk potencohet se ndalohet angazhimi i stafit të njëjtë nga operator të ndryshëm, nëse të njëjtit operator ekonomik marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit, po ashtu AK vetëm e ka potencuar si fakt se i njëjti inxhinier është angazhuar tek dy operatoret ekonomik- OE ankuese dhe “AC ing” Sh.p.k , me rastin e eliminimit të OE ankuese mirëpo nuk e ka potencuar se me cilën dispozitë të legjislacionit për prokurim publik është i ndaluar një veprim i tillë.

Po ashtu, eksperti shqyrtues konstaton se rast të ngjashëm OSHP ka trajtuar edhe me Vendimin PSH 857/19 te datës 17.01.2020.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së me arsyetimin se: “njëjta OE ka dorëzuar ofertë financiare më të lirë se sa oferta e OE të rekanduar për kontratë” duke u bazuar në pretendimet e cekuar më lartë dhe faktet e gjitura me rastin e trajtimit te lendes, eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi i OE ankuese **është i bazuar** sepse AK, ka rekanduar për kontratë ”Olti Trasing” Sh.p.k e cila ka dorëzuar ofertë me vlerë financiare prej: **546,600.00 €**, ndërsa OE ankues ka dorëzuar ofertë financiare në vlerë prej **488,000.00 €** e cila është më e lirë në vlerë prej **58,600.00 €** se sa oferta e OE te rekanduar për kontratë, me këtë veprim AK ka vepruar në

kundërshtim me kriterin çmimi më i lirë te parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit si dhe me paragrafin 1.1 të pikës 1 të nenit 60 të LPP-së ku thuhet se: "Autoriteti kontraktues do t'i ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët".

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 27.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 02.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i iniciimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues OE "ASTRAPLAN" Sh.p.k.- Prishtinë, se AK ka bërë shkelje të nenit 6, 7, 10, 56, 59 dhe 108 A të LPP-së dhe nenit 49.19 te RrUOPP, si dhe nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, me arsyetimin se:

"Eliminimi i saj nga AK që ndërlidhen me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional respektivisht kërkesës qe ndërlidhen me dëshmitë e inxhinierit te ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik është në kundërshtim me dispozitat e lartë cekura,"

Paneli Shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar sepse AK në njoftimin për kontratë dhe në FTD të dosjes se tenderit ka parashtruar kërkesën si vijon: 3. Një inxhinier i dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit; kurse dëshmja e kërkuar dokumentare është kërkuar:

Dëshmia 1-6 Për menaxherin e Projektit Personelin Kryesor Teknik të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuara , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar

nga punëdhënësit. Për udhëheqësin e punimeve dhe personelin teknik diplomat duhet të jetë te noterizuara. (Diplomat jashtë shtetit duhet të jen të nostifikuara)

Për këtë kriter në dosje të tenderit, OE ankues së bashku me dosjen e tenderit ka dorëzuar listën e personelit udhëheqës, në të cilën liste ka paraqitur të dhënat e z. Arben Hajrizi në cilësinë e inxhinierit te dip. te ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik, po ashtu për të njëjtin ka dorëzuar dëshmitë, kopjen e diplomës së inxhinierit të ndërtimtarisë të lëshuar nga Fakulteti i Ndërtimtarisë, Universiteti i Prishtinës të vërtetuar tek noteri, kopjen e kontratës së punës për kohë të caktuar, CV dhe referencat e lëshuara nga USAID dhe IRD të cilat dëshmi e plotësojnë kërkesën e parashtruar nga AK në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Paneli Shqyrtues konform sqaron se i njëjti inxhinier respektivisht z. Arben Hajrizi është paraqitur si staf me kontratë pune me kohë të caktuar te operatori ekonomik "AC ing" Sh.p.k e cila është pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit si anëtar i konzorciumit tek grapi i OE "AC ing Shpk & Vellezrit Hoti Sh.p.k". Mirëpo, Paneli Shqyrtues konstaton se askund në legjislacionin për prokurim publik nuk potencohet se ndalohet angazhimi i stafit të njëjtë nga operator të ndryshëm, nëse të njëjtit operator ekonomik marrin pjesë në një aktivitet të prokurimit. Po ashtu, AK vetëm e ka potencuar si fakt se i njëjti inxhinier është angazhuar tek dy operatoret ekonomik, tek OE ankues dhe "AC ing" Sh.p.k, me rastin e eliminimit të OE ankuese. Pra, AK nuk e ka potencuar se me cilën dispozitë të legjislacionit për prokurim publik është i ndaluar një veprim i tillë.

Andaj, Paneli Shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit të ofertave duhet të kërkoj sqarime shtesë nga te dy OE-te se ku është i punësuar personi ne fjale duke e dëshmuar me lista të Trustit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK ka bërë shkelje të nenit 60 të LPP-së me arsyetimin se: "njëta OE ka dorëzuar ofertë financiare më të lirë se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë". Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka rekomanduar për kontratë "Olti Trasing" Sh.p.k e cila ka dorëzuar ofertë me vlerë financiare prej 546,600.00 €, ndërsa OE ankues ka dorëzuar ofertë financiare në vlerë prej 488,000.00 € e cila është më e lirë në vlerë prej 58,600.00 € se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Megjithatë, përderisa nuk kemi një vlerësim final dhe konstatim nëse OE ankues i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, atëherë është e pamundur që të konstatohet nëse tenderi i OE ankues përbush kriterin çmimi më i lirë të parashtruar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, sikurse është përcaktuar në paragrafin 1.1 të pikës 1 të nenit 60 të LPP-së, ku thuhet se: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap konratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët". Andaj, ky pretendim ankimore është pjesërisht i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues duhet të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së lidhur me inxhinierin në fjalë dhe të vërtetoj në ATK se tek cili operator ekonomik është i punësuar ky inxhinier dhe pastaj të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Ministria e Arsimit.
- 1x1 OE "Astraplan"Sh.p.k.- Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.